



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice-Departamenti për  
Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comite

DPL.nr.21/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.1097/20, P.nr.1093/20, P.nr.1094/20, P.nr.1095/20, P.nr.1096/20, P.nr.1097/20, P.nr.1098/20, P.nr.1099/20, P.nr.1100/20 dhe P.nr.1101/20 pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese , me seli në të cilën e përfaqëson , pas seancës së mbajtur në praninë e përfaqësuesit të palës ankuese dhe në mungesë të përmbaruesit privat, të ftuar me rregull , me datën 21.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat , i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit, në veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.1097/20, P.nr.1093/20, P.nr.1094/20, P.nr.1095/20, P.nr.1096/20, P.nr.1097/20, P.nr.1098/20, P.nr.1099/20, P.nr.1100/20 dhe P.nr.1101/20, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 1,500.00 euro (njëmijë e pesëqind), të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Kosovës, nën kërcënimin e përmbarimit.

### A r s y e t i m

Pala ankuese me datën 17.05.2022, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesionet e Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbartimin Privat ndaj përmbartuesit privat, për shkak të ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore lidhur me lëndët përmbartimore, P.nr.1097/20, P.nr.1093/20, P.nr.1094/20, P.nr.1095/20, P.nr.1096/20, P.nr.1097/20, P.nr.1098/20, P.nr.1099/20, P.nr.1100/20 dhe P.nr.1101/20, ka kryer shkelje të dispozitave të LPP-së, duke i tejkaluar autorizimet e tij të përcaktuara me ligj.

Në vazhdim, pala ankuese ka deklaruar se nga përmbartuesi privat përmes postës elektronike është kërkuar pasqyra e procedurës përmbartimore përfshirë edhe konkluzionin e fundit, faturat e propozimit për përmbartim dhe faturat e shpenzimeve të procedurës në imeill ose me postë. Me këtë rast ankuesi ka parashtruar se përmbartuesi privat, nuk i ka respektuar kompetencat e përcaktuara me ligj për përfundimin e përmbartimit, duke i shkaktuar dëm, ka rrezikuar që të mos ketë faturë me arsyetimin e tërheqjes së shumës së mjeteve pranë ATK-së, pasi që debitori në këtë rast, pala ankuese është operator ekonomik dhe i kërkohen faturat. Andaj, mbi këtë bazë edhe konsideron se përmbartuesi privat ka shkelë ligjin dhe kodin e etikës profesionale. Prandaj, i ka propozuar komisionit disiplinor që në përputhje me nenin 373, të LPP-së të ndërmerr veprimet e nevojshme.

Përmbartuesi privat, në përgjigjen e tij me shkrim e ka kundërshtuar si të pabazë ankesën e palës ankuese, ngase pretendimet e ankuesit janë të pavërteta pasi që debitori- pala ankuese edhe sikur mos t'a pranonte asnjëherë urdhërin për përfundim, ai e ka propozimin për përmbartim e poashtu në rrjedhën e llogarisë i shkruan se nga kush janë tërhequr dhe për çka janë tërhequr mjetet. Këto kërkesa sipas përmbartuesit privat, ATK-ja nuk ia bën askujt se kush t'i ketë tërhequr mjetet, mirëpo këto pretendime nga pala ankuese janë fallce dhe vetëm përpjekje për mashtrim të komisionit disiplinor. Faturën mbi të cilën është lejuar urdhëri - faturën e përmbartuesit dhe urdhërin për përmbartim, përmbartuesi ka theksuar se ia ka dërguar debitorit në ditën e paraqitjes së kësaj përgjigjeje në ankesë, respektivisht me datën 31.05.2022 në adresë në \_\_\_\_\_, sepse adresë tjetër debitori nuk kishte siguruar. Nëse faturën e përmbartuesit nuk ka mundur debitori t'a parashtrorë pranë ATK-së, atëherë këtë mundësi, ATK-ja e ofron përmes ëeb faqes së saj, tek korrigjimi i deklarimeve tatimore ku mund të përmirësohen deklarimet, madje deri në 7 vite të vjetra, pastaj ekziston edhe mundësia e deklarimit si fatura e parë për muajin vijues. Nga kjo sipas përmbartuesit privat, rezulton se ekzistojnë disa zgjidhje për këtë çështje.

Përmbartuesi privat, për arësyet e cekura si më lart, i propozoi komisionit disiplinor që ankesa të refuzohet si e pabazuar.



Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim se përmbaruesi privat, ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni vlerëson se sa i përket pretendimeve të përmbaruesit privat që janë në kundërshtim me ligjin dhe që e kanë tejkaluar autorizimin e tij me rastin e zbatimit të përmbarimit , përmbaruesi privat nuk kishte vepruar në bazë të dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore te rastet P.nr.1097/20, P.nr.1093/20, P.nr.1094/20, P.nr.1095/20, P.nr.1096/20, P.nr.1097/20, P.nr.1098/20, P.nr.1099/20, P.nr.1100/20 dhe P.nr.1101/20.

Sipas nenit 9 të LPP-së gjatë zhvillimit të një procedure përmbarimore, përmbaruesi privat është i detyruar t'i kushtojë rëndësi mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, në mënyrë që përmbarimi të jetë sa më i padëmshëm që është e mundur për debitorin. Në rastin konkret , komisioni gjen se përmbaruesi privat nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ruajtjen e dinjitetit të debitorit ashtu siç obligohet me dispozitën e lartë cekur, duke e sjellur debitorin në vështirësi me fatura pranë ATK-së, madje nuk ka dhënë urdhër për përfundimin e procedurës përmbarimore deri në ditën e ushtrimit të përgjigjes në këtë ankesë me datë 31.05.2022 siç e deklaroi vet përmbaruesi privat me anë të përgjigjes në padi. Andaj me këtë rast komisioni vlerëson se përmbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 , paragrafi 1 nën paragrafi 1 i LPP-së, për arsyet e dhëna si më lart.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, historiatin e shkeljeve disiplinore të kësaj natyre, pasi që të njëjtit përmbarues, i është shqiptuar më herët gjobë nga Komisioni Disiplinor, sipas vendimit DPL.nr.05-2021 të datës 30.04.2021, veçanërisht faktin për peshën e dëmit të shkaktuar ndaj palës ankuese, e cila ka ndikuar në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit. Komisioni vlerëson se masa e shqiptuar do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve përmbarimore, të përmbaruesi privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, edhe është qëllimi i masës. Ndërsa, detyrimin se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, komisioni e bazoi në nenin 368, paragrafi 3 të LPP-së, në të cilën përcaktohet se gjobat në të holla, paguhet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 21/2022 datë 21.07.2022**

**Kryesuesja e Komisionit disiplinor**  
**Manushe Karaçi**



***KËSHILLË JURIDIKE:*** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.